



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.79/2016

Prishtinë, më 15.11.2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha – Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rustem Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë, Sasha Milosavljeviç, zëvendëskryetar i dytë, dhe Enver Hoti, anëtar.

Pjesëmarrës i ftuar: Krenar Bujupi, u.d. kryesues i Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE).

Pjesëmarrës të tjerë: Arsim Janova, Petrit Pepaj, Gani Buçaj dhe Ymer Fejzullahu, ZRRE; Shefik Kurteshi dhe Ekrem Hajdari, AKP; Burim Ejupi, INDEP; Fjolla Uka, KDI; Suzana Bunjaku, Rrokum TV; Sanije Jusufi, gazeta “Koha ditore”; Etleva Malushaj, LVV; Qëndresa Misini, Mirlinda Kelmendi, praktikante.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 8.11.2016;
3. Problemet aktuale të furnizimit me energji elektrike;
4. Shqyrtimi i nismës legislative: “Plotësimi i Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit”;
5. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-117 për akreditim;
6. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 8.11.2016

Raif Qela – Në procesverbalin e mbledhjes së kaluar, është debatuar lidhur me nismën ligjore të propozuar nga AKP-ja, ku gjatë debatit është shtruar edhe çështja, se përveç punonjësve të autorizuar të cilët mund ta mbrojnë kompaninë, mund të mbrohet edhe nga jashtë, ndërsa propozimi për këtë, e as debati për këtë, nuk është theksuar në procesverbal. Mendoj së është më mjaft me rendësi, sepse e di që unë e kam përmendur, por edhe të tjerët kanë debatuar në këtë frymë dhe në këtë frymë, pastaj dje në mbledhjen e grupit punues edhe është amendamentuar nisma ligjore.

Procesverbali i mbledhjes së datës 8.11.2016, u miratua me plotësimin e propozuar nga z. Qela.

3. Problemet aktuale të furnizimit me energji elektrike

Kryetari – Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, pra për problemet e fundit të furnizimit me energji elektrike, kam kërkuar që të na dërgohet një informatë me shkrim nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE). Informatën me shkrim na e ka dërguar ZRRE-ja, dhe lidhur me këtë çështje, është i ftuar për të raportuar edhe me gojë Bordi i ZRRE-së, përfaqësuesit të të cilit ia dha fjalën, për të paraqitur informatën.

Krenar Bujupi (u.d. kryesues i Bordit të ZRRE-së) – Gjatë përmbushjes së detyrave tona, iu kemi përgjigjur edhe Komisionit disa herë, për kërkesat që kanë të bëjnë më monitorimin e ndërmarrjeve të licencuara të sektorit të energjisë elektrike. Raporti mbi të gjitha ndërmarrjet e licencuara, të cilat në raport i kemi ndarë me ju, edhe pse nuk janë në formën e finalizuar d.m.th. ende janë drafte që janë në diskutim dhe konsultim dhe duhet të shikohen për sa i përket gjendjes faktike, duhet të kontrollohen edhe një herë nga të licencuarit dhe nga departamentet përkatëse të ZRRE-së, dhe vetëm atëherë kur të dalim para bordit, do të finalizohen dhe normalisht do të marrim edhe ndonjë masë tjetër apo rekomandim tjetër, të cilin bordi e sheh të arsyeshme. Në vazhdimësi, jemi duke i monitoruar dhe duke i shikuar edhe sa i përket investimeve kapitale, sepse ka qenë edhe brengë e Komisionit për investime kapitale në sektorin e energjisë dhe për ankesat në sektorin e energjisë, ndërsa sa i përket ankesave për energji, që kanë dalë gjatë muajit tetor, ZRRE-ja, menjëherë pas pranimit të disa ankesave për ndërprerje të energjisë elektrike, kemi kontaktuar menjëherë me KEDS-in, ku kemi kërkuar informata të detajuara për çdo ndërprerje që ka qenë në sistemin e energjisë elektrike, gjatë muajit tetor. Mirëpo, ne i kemi prezantuar disa shifra. Pra, mund të themi se këto janë detaje shumë të mëdha, janë fajlla të tërë të Excel-it për ndërprerje dhe secila prej ndërprerjeve ka arsye të posaçme për atë ndërprerje. Këto ndërprerje analizohen me kujdes nga ne apo nga Departamenti për Ankesa të Konsumatorëve, dhe pastaj shikohet nëse ka ndonjë masë që duhet të merret. Ndoshta, duhet vetëm thjesht një shpjegim, ndërprerjet në sistemin tonë energjetik ndodhin për arsye të planifikimit, kur kemi mirëmbajtje të rregullt, pra ndodhin nganjëherë kur kemi ndërprerje të paplanifikuar që zakonisht janë nga prishjet që ndodhin dhe e kemi edhe një problem tjetër në

Kosovë, për shkak të mungesës së rezervave, mund të ndodhë edhe ndërprerja, kur ndonjëra prej njësive gjeneruese bie nga funksioni, dhe në mungesë të rezervave të energjisë elektrike, atëherë mund të kemi ndërprerje në periudhën 4-5 orë. ZRRE-ja, në vazhdimësi i ka përmirësuar shërbimet ndaj konsumatorit, nëpërmjet KESKO-s, d.m.th duke obliguar KESKO-n, në vazhdimësi, që të kontaktojmë dhe të monitorojmë, si dhe i rekomandojmë për përmirësim të shërbimeve të tyre, sa i përket konsumatorëve.

Raif Qela—Nga raporti, që duket se është i shkurtër, por janë dhënë mjaft të dhëna, mund t'i nxjerr disa pyetje, ku thuhet se bazuar në të dhënat energjetike të prodhimit të konsumit dhe konsumatorit, të rregulluara e të tjera, ndërprerjet e energjisë elektrike gjatë muajit tetor 2016, mund të vijnë vetëm si pasojë e prishjes në rrjet dhe nevojës për mirëmbajtje të rregullt të rrjetit dhe të gjithë operatorit. A është investuar në rrjet në vitin e planifikuar, sidomos pse të bëhen mirëmbajtje të rregullta në këtë periudhë dhe a ka mundësi që këto të reduktohen brenda periudhës kur ka nevojë më të vogël për energji elektrike? Pastaj ankesat e konsumatorëve, lidhur me faturat e larta mund të rezultojnë pozitive nga ana e KEDS dhe të tjera. Sa mund të ndikojë në faturë edhe mënyra e parregullt e regjistrimit të shpenzimeve, sepse siç e keni thënë diku +/- 2 ditë për një konsumator, është shumë, sidomos në periudhën e pikut, kur ka nevojë të madhe për energji. Pra, ata që ngrohen me energji, edhe nëse në shkurt 2 ditë më përpara i regjistrohet shpenzimi, i bie që në muajt e tjerë, në janar dhe në mars, të jenë për dy ditë më shumë dhe rrjedhimisht, për shkak se është edhe fatura e periudhës së dimrit, shpenzimet do të jenë ndoshta deri në 1/3 më të larta sesa do të ishte dashur të bëhen. Është thënë se gjatë fillimit të sezonit të lartë, në përgjithësi, ankesat e konsumatorëve kanë të bëjnë më shumë me çmime të aplikuara se sa gjatë sezonit të lartë dhe nuk kanë të bëjnë me sasinë e kilovat-orëve të regjistruara në njehsorë, konsumatori pjesa më e madhe e tyre, nuk di ta ndajë këtë çështje për një arsye shumë të thjeshtë, sepse ata shpesh nuk mund të kenë qasje në orët e tyre të rrymës, sepse diku janë të mbyllura, në ndërtesa janë të mbyllura dyert e orëve të rrymës dhe nuk mund ta dinë se sa kanë shpenzuar, sepse duhet ta regjistrojnë në përpikëri në ditën në të cilën ata kanë shpenzuar, prandaj të mos bazohemi në këto dhe të themi që më shumë kanë të bëjnë me çmimet e aplikuara, sesa me sasinë e kilovat-orëve, sepse shumica e tyre, sigurisht që do të ishin ankuar, për të sqaruar këtë çështje. E keni përmendur se FERRONIKELI, deri më 1 tetor ka pasur ndërprerje të rrymës, pastaj e keni thënë diku se faturimi të konsumatorët industrialë, për muajin tetor 2016, është më i madh për rreth 14%. Si është e mundur të jetë për konsumatorët industrialë faturimi rreth 14%, përderisa nuk ka punuar FERRONIKELI fare? Sa ndikon kjo në përgjithësi në tarifën e konsumatorëve industrialë dhe të konsumatorëve në përgjithësi, nëse një konsumator kaq i madh nuk ka pasur? Po ashtu, kam kërkuar ndoshta më shumë se para një viti, që të na dërgohet formula, me anë të së cilës krijohen tarifën, që edhe ne ta dimë me saktësi se si nxjerrën tarifën. Unë nuk e di se na e keni sjellë ndonjëherë dhe nuk na e keni shpjeguar asnjëherë. Pra, kjo është me rendësi për ne, që ta dimë se sa po zbatohet kjo çështje.

Kryetari – Nga të dhënat që na i keni prezantuar ju, te importi i energjisë, shihet një import dukshëm më i vogël këtë vit, 54%, eksporti dukshëm më i madh se sa vitin e kaluar. A është kjo një nga shkaqet pse ka ndërprerje të rrymës në Kosovë?

Blerim Grainca – Nga raporti shohim se rritja e konsumit, sidomos tek konsumatorët shtëpiakë, është rritur shumë, po ashtu është rritur edhe faturimi në raport me vitin 2015, diku për 5-6 %, megjithatë problemet mbesin të njëjta. Unë do ta ngre si shqetësim ndërprerjen që ndodh

zakonisht në zonat rurale. Kemi fshatra të tëra, që mbesin pa energji elektrike, me orë të tëra. Kjo po përsëritet jo vetëm këta muaj, por ka pasur probleme të tilla edhe gjatë verës, prandaj më intereson se ku është problematika, sepse rriten shpenzimet, rritet faturimi dhe kjo nuk po përcillet me mirëmbajtje qoftë të rrjetit, qoftë për furnizim, andaj do të ishte mirë që ZRRE-ja ta ketë parasysh këtë problematikë, veçanërisht për zonat e thella. Po ashtu, është edhe një problematikë, që duhet ta keni parasysh, veçanërisht faturimet që bëhen për shpenzimet e përbashkëta, p.sh. kemi objekte të cilat kanë një orë të përbashkët, ku shpenzimet e ndriçimit, sidomos për zonat urbane dhe faturat për këto orë, shembull një hyrje, ku janë 30 banesa, ora që është e përbashkët, zakonisht ato po rriten dhe kemi mjaft ankesa nga qytetarët se shpenzimet e përbashkëta, po fryhen faturat dhe gjithë kjo ka bërë që të kemi një numër të madh të ankesave, të cilat nuk kanë zgjidhje nganjëherë.

Besim Beqaj – Sigurisht, që e kam shikuar me kujdes raportin dhe i përshëndes përfaqësuesit e ZRRE-së dhe besoj që raporti është i mirë, për ata që e njohin punën në mënyrë të detajuar, por sigurisht për qytetarin është goxha i pakuptueshëm. Po ashtu, Besoj që do të ishte mirë të na shpjegoni çka ndodh me eksportin dhe me fitimin nga eksporti dhe si financohet importi, pra këtë dilemë duhet hequr qytetarëve, që nëse nga eksporti është duke fituar dikush ose duhet të tregohet, nëse po fiton dikush mbi këtë bazë dhe ndoshta do të duhet të shpjegohet saktësisht kjo çështje e ndërprerjeve. Për çështje të mirëmbajtjes, pra si rregullator, a jeni ju të bindur se duhet pasur ndërprerje në këtë kohë për mirëmbajtje apo jo? Nëse jo, besoj që duhet të jetë ashtu, cilat masa i keni marrë që ata të jenë më mirë të planifikuara në procesin e ndërprerjeve? Dhe tek çështja e orëve, ju e dini që ka qenë goxha problematike kjo pjesa e barazimit. A po vazhdon ajo të jetë ende problem apo nuk po vazhdon të jetë problem? Ndërsa, çështje me theksin më të fuqishëm, që besoj që dallon në faturë, është kjo që tha z. Qela, +/- 2, kjo nuk nënkupton vetëm dy ditë, por nënkupton 4 ditë, pra 4 ditë të futura në tarifa dimërore, duke hequr nga tarifa verore, janë shumë.

Krenar Bujupi (ZRRE)–Ndoshta vetëm në përgjithësi, së pari desha të shpjegoj disa prej gjërave që ZRRE-ja i bën për marrjen e masave, për të paplanifikuara dhe të planifikuara, d.m.th. për ndërprerjet. Ne kemi udhëzuar dhe vazhdimisht e udhëzojmë KESKO-n dhe KEDS-in, që sa më shumë të sillen mirë, si dhe t'i njoftojnë të gjithë konsumatorët për ndërprerjet e planifikuara. Besoj që edhe Komisioni pajtohet që kjo është duke ndodhur, sepse nëpër media jemi duke parë çdo ditë komunikata ku tregojnë për ndërprerjet, se kur do të jenë dhe cilat rajone i përfshijnë. Për ndërprerjet e paplanifikuara i kemi kërkuar që të ndërmerren masa se si të mbajnë p.sh. 24 orë në dispozicion, ekipe të rregullta dhe të veçanta në të gjitha rajonet të cilat duhet të reagojnë në eliminimin e prishjeve, d.m.th në vazhdimësi jemi duke i kontrolluar dhe duke i monitoruar. Çështja se kur duhet të ndodhin investimet, është e vërtetë që gjatë periudhës kur e kemi konsumin e lartë, ndodhin gjëra të mirëmbajtjes, gjëra të investimeve dhe normalisht që na krijon pak probleme, mirëpo në anën tjetër, disa prej këtyre investimeve duhet të bëhen para se të fillojë dhe para se të shkojë sezoni në maksimum, kështu që disa prej investimeve që duhet kryhen, disa prej mirëmbajtjeve që duhet të bëhen, për t'u përgatitur për këtë konsumin e lartë që na vjen në sezonin e dimrit, dhe gjatë kësaj kohe, por edhe në kohë tjera, planet e mirëmbajtjes analizohen me kujdes dhe vendosen se si do të ndodhin investimet.

Besim Beqaj – Një pyetje shtesë, ata sigurisht duhet të dorëzojnë një plan të investimeve dhe ju duhet ta miratoni atë plan të investimeve, sepse pa e miratuar ju, ata nuk mund të investojnë apo jo. A i keni miratuar këto intervenime tash apo jo?

Krenar Bujupi (ZRRE) – Planin e investimeve e kanë të miratuar.

Besim Beqaj – A e kanë të miratuar edhe në këtë kohë?

Krenar Bujupi (ZRRE) – Po, edhe në këtë kohë.

Besim Beqaj – Duhet ta dimë se a janë duke e bërë atë punë me të drejtë apo nuk janë duke e bërë atë punë me të drejtë. Do të duhej që në të ardhmen të keni shumë kujdes, që mos të miratoni në këtë kohë planin e investimeve.

Kryetari – Neve po na intereson kjo situata e ndërprerjeve, eksportit e importit, për këtë ju kemi thirrur, se ju do ta sillni edhe raportin dhe sa më konkretisht të përqendrohemi këtu.

Krenar Bujupi (ZRRE) – Çështja e importit dhe eksportit, deri më tani, siç e dini të gjithë, kemi qenë në një sektor, ku tarifat kanë qenë të rregulluara komplet, që nga gjenerimi e deri te konsumatori fundor. D.m.th. çdo element i sektorit energjetik ka qenë i rregulluar nga ZRRE-ja, sipas ligjeve në fuqi. Pra, kjo do të thotë se çdo benefit apo çdo kosto e sistemit energjetik iu ka faturuar konsumatorit. D.m.th. sistemi funksionin asi soj që nuk ka përfitim asnjë entitet i rregulluar në sektorin e energjisë për çështjen, nëse bëjnë eksport më shumë apo bëjnë eksport më pak, madje në rregulloren tonë ka qenë që ndërmarrjeve energjetike t’iu jepet një iniciativë për të eksportuar. Pra, d.m.th. tarifa kalkulohet në atë mënyre që kthehet tek konsumatori. Tarifa shumë thjeshtë është formuluar, por ajo e parasheh një gjë, të gjitha kostot që i ka sistemi përkthen në konsumin, se sa do t’i ketë, ashtu rregullohet tarifa.

Kryetari – Nëse teorikisht çmimi i importit është shumë më i lartë se çmimi i KEK-ut, të cilin e blejnë 27 euro megavatit, kurse prej importit është çmimi 50-60-70 euro apo edhe më shumë, por 27 asnjëherë, domethënë është më i lartë sesa i KEK-ut, varet nga sasia dhe momenti i blerjes, nëse kemi pasur eksport dhe kemi pasur shumë më pak import sesa vitin e kaluar. Logjikisht, çmimi për të ardhurat e lejuara do të duhej të ulej. A do të thotë kjo që për atë muaj ose muajin vijues do të ulen faturat konsumatorëve, nëse ju kthehen konsumatorëve, duam të dimë se si ju kthehen konsumatorëve?

Krenar Bujupi (ZRRE) – Gjatë gjithë kohës, bëjnë azhurnime. Çështja e eksportit dhe importit, pse ndodh kështu? Të shpjegojmë së pari se me gjithë qejf e kishim marrë tërë energjinë nga KEK-u dhe nuk kishim pasur nevojë për import fare, mirëpo për shkak të sistemit që e kemi në Kosovë, konsumi ynë ndryshon nga dita në natë. E kemi njëfarë ndryshimi që do të thotë dy me një, nganjëherë shkon edhe më shumë, ndërsa në anën tjetër, KEK-un e kemi me njësi gjeneruese apo sistemin energjetik tonin, nuk kemi njësi gjeneruese dhe nuk kemi fleksibilitet, nuk kemi njësi gjeneruese. Për shkak të jofleksibilitetit të KEK-ut, nuk është e arsyeshme, teknikisht nga ana inxhinierike të ndalen dhe të lëshohen gjeneratorët apo vetëm duke punuar në minime teknike. Gjatë natës, nëpër të gjitha vendet e rajonit, çmimi është më lirë, kurse nevojitet importi në kohë të caktuar gjatë pikut të ditës dhe për këtë paraqitet nevoja e eksportit dhe importit, që duhet të rregullohet.

Kryetari – Ky eksport dhe import dhe situata që ka ndodhur gjatë vitit, sa është në harmoni me të ardhurat e lejuara dhe sa ka shmangie nga të ardhurat e lejuara, që ia keni lejuar çmimin, në bazë të të cilit është formuar çmimi?

Krenar Bujupi – Nuk kisha dashur të hyj në aq detaje se sa ka tash.

Kryetari – Kjo është me rendësi për neve.

Krenar Bujupi (ZRRE) – Ne i kemi dhënë ndryshimet në mes të secilës kategori se qysh kanë ndryshuar, mirëpo kur vijmë te ndryshimi i këtyre tarifave dhe impakti i këtyre kategorive në tarifa, ka një kalkulim më të komplikuar, që duhet të bëhet për të treguar atë ndryshim, por në kategoritë e importit dhe eksportit ka një ndryshim, sepse nuk kemi fare import gjatë këtij muaji.

Besim Beqaj – A bëni eksport atëherë kur ka nevojë për rrymë në Kosovë? Pra, që ta kuptojnë qytetarët më thjesht, thuaje qartë, nëse nuk ka eksport ose ka eksport, vetëm atëherë kur na tepron rrymë.

Krenar Bujupi (ZRRE) – E kam problem që t’i përgjigjem kësaj pyetjeje, se nuk e di a ka ende benefite apo kosto shtesë. Nuk mund të bazohem vetëm në këtë, duhet të bazohemi edhe në të hyrat dhe në të gjitha kostot tjera që kanë ndodhur gjatë sistemit. Ne, në fund të vitit, e bëjmë azhurnimin e kostove nga ato që i kemi planifikuar në ato reale, kështu që na nevojitet medoemos kohë për shqyrtimin e tarifave, për t’u parë në bazë të shqyrtimit tarifor a kthehen të gjitha kostot, d.m.th. sistemi energjetik lejon azhurnimin në aso mënyre, që çdo kosto që ka qenë mbi kosto paguhet prej konsumatorit, ndërsa çdo benefit që ka qenë mbi atë të parashikuar, kthehet tek konsumatori.

Fatmir Rexhepi – Sa i përket çmimit të importit dhe çmimit vendor të prodhimit, ne po mundohemi të kërkojmë diçka, për të pasur çmim të ulët për konsumatorin, por është e pamundur. Ne jemi ata që prej vitit 2004 nuk kemi ndërtuar asnjë termocentral, kështu që nuk kemi të drejtë të ankohemi për kurrjë, sepse qytetarët duhet të ankohen tek ne. Tash a ka shanse për të bërë çmim më të lirë, nuk ka shanse. Në vitet e ardhshme, në çdo vit do të jetë më shtrenjtë. Sikur të ishte ndërtuar termocentrali me kohë, sot i kishim ndryshe punët. Unë mendoj se ndërtimi i termocentralit është ky faktor kyç, kështu që ne mundohemi tash të gjejmë çfarëdo formule, e kalkulime të tjera, por kot. Mirëpo, punët duhet mbikëqyrur, sipas rendit të shtëpisë, duhet kontrolluar KEK-un, është normale dhe e arsyeshme.

Kryetari – Ne duhet t’i përcjellim shqetësimet e konsumatorëve dhe të qytetareve z. Rexhepi. Nëse ju nuk jeni të shqetësuar, të tjerët kanë të drejtë të shqetësohen, vazhdo të mos shqetësohesh ti.

Fatmir Rexhepi–Nëse është kështu, atëherë le t’iu bëjë KEDS-i çmim të njëjtë të gjithë prodhuese, siç ia kanë bërë çmimin FERRONIKELIT, por nuk mundeni. Ejani, bëjeni nëse dëshironi t’i stimuloni prodhuesit vendorë. A janë të zotët ta bëjnë? Jo.

Kryetari – Kjo është një temë tjetër. Ti i ke përzier temat z. Rexhepi. Ajo që e keni çelë ju, është një temë tjetër. Ne po flasim për një temë tjetër.

Krenar Bujupi (ZRRE) – Dua t’ju them se që nga koha kur është miratuar lexuesi mobil, nuk kemi pasur shumë ankesa për sasi të konsumit, sepse ato gjëra që kanë qenë realisht të vërtetuara më herët, se kur u lexohej konsumi dhe fatura mbërrinte pas dy ose tre ditësh. Konsumatori kishte probleme me ditë se a është duke e përcjellë konsumin. Pas lexuesit mobil, më nuk ekziston ai problem, sepse në moment e lexon edhe e nxjerr faturën, kështu që në momentin që konsumatori e sheh faturën, ndryshimi mund të jetë vetëm një kilovat. Sa i përket vet çmimit të energjisë elektrike që e kemi +/- 2, e njëjta gjë ka qenë dhe menjëherë pasi kemi filluar me lexues mobilë, ky +/-2-shi është si lejim, por nuk aplikohet. Ne nuk kemi parë raste të dëshmuara, të cilat konsumatori lexohet për më shumë se një muaj që është 30 apo 31 ditë. Ajo +/- ka mbetur vetëm ai 1–shi, por lexohet në mënyrë shumë të rregullt, sepse datat i shikojmë në mënyrë të rregullt.

Raif Qela – Ju e përmendet këtë çështje, për dy ditë, ka mundësi që atëherë kur tarifa është e lartë dhe blloku i tretë mbi 600 kilovatë, tarifa është jashtëzakonisht më e lartë, sesa po të jetë në dy muaj me tarifë të ulët, respektivisht, si do që të jetë, me tarifa deri në 200 kilovatë orë, kjo i bie që do të ishte dashur që atëherë kur bëhet leximi i gabuar ose me vonesë për një apo dy ditë, të bëhet në dobi të konsumatorit, në atë mënyrë që sasia e tepruar për dy ose tre muaj mbi 200 kilovatë orë mesatare, t’i faturohet atij, e jo t’i faturohet vetëm për një muaj, nëse është bërë gabim në lexim.

Muhamet Mustafa –E thashë edhe një herë, po kthehem tek importi për këta dhjetë muaj që nuk na e keni dhënë në komulative, ku janë importuar 30 milionë për dhjetë muaj, që këtë vit janë 10 milionë. A shihni ndonjë korrelacion midis ndërprerjes së rrymës dhe importit?

Krenar Bujupi (ZRRE) – Jokorrelacione ekzistojnë në mes të importit dhe FERRONIKELIT. Vetëm ta kuptojmë, d.m.th. FERRONIKELI, siç ka qenë edhe me ligjet e kaluara, por edhe me ligjet e reja, e kemi obligim të gjithë konsumatorëve, të cilët janë të mëdhenj, të dalin në tregun e hapur, treg i cili nuk është i rregulluar. Në momentin që ka dalë FERRONIKELI në tregun e hapur, nevoja për importin që ka qenë tani, është zvogëluar dukshëm, për atë edhe është rritur, sepse kemi prodhim vendor. Ndërsa, eksporti është rritur, sepse siç thashë, fleksibiliteti ka qenë i parashikuar ashtu, sepse FERRONIKELI, tani për tani konsumon energji e cila është 100% e importuar jashtë Kosovës dhe i gjithë importi që ka qenë i paraparë, kur e kemi paraparë FERRONIKELIN për të qenë pjesë e faturave të rregulluara, tash ka ra në mënyrë të ndjeshme, për shkak të industrisë, sepse është një konsumator shumë i madh. Domethënë, korrelacioni nuk është në asnjë moment, nuk kemi parë ne si rregullator, gjatë analizave tona, korrelacion në mes të ndërprerjeve të energjisë elektrike dhe importit. Korrelacioni ekziston, por ai është në mes të FERRONIKELIT apo daljes së FERRONIKELIT nga tarifatat e rregulluara dhe për atë po na ndodhin çështje apo kemi disa rezultate që nuk i kemi parashikuar mirë, sa i përket bilancit, importeve dhe eksporteve, d.m.th. ai është korrelacioni.

Sala Berisha – Shala – Ju përmendet se me marrëveshjen me FERRONIKELIN, për tarifa të parregulluara, është zvogëluar importi i energjisë elektrike, ndërkohë që realisht, unë nuk po e kuptoj. Drenasi përballet me reduktime drastike të rrymës. Ndalja e rrymës shpesh, dhe me nga një javë ditë, a ka ndikuar kjo marrëveshje, pse po ndodh kjo?

Krenar Bujupi (ZRRE) – Është e vërtetë që ka pasur pak problem me daljet e FERRONIKELIT për qytetarët e Drenasit, por kjo ka qenë problematikë, për shkak të teknikes, sepse kanë qenë në të njëjtën dalje edhe qytetarët e Drenasit, edhe FERRONIKELI dhe nuk kemi pasur probleme, derisa kemi qenë të gjithë të rregulluar. Pra, nuk kemi pasur problem për matje, për kontroll, për monitorim dhe të gjitha gjërat që ne realisht duhet bërë, si ZRRE. Në momentin kur ka dalë FERRONIKELI në sektorin e parregulluar dhe dalja duhet bërë e veçantë, në mënyrë që ne të jemi më të sigurt në monitorimin e biznesit të parregulluar. Pra, ka qenë një periudhë ndoshta një ose dy javë që ka pasur realisht ndërprerje të energjisë elektrike në Komunën e Drenasit, për shkak të punimeve që janë bërë, për të bërë këtë ndarje, por këto gjëra nganjëherë ndodhin dhe nuk ka qenë faji as i FERRONIKELIT, as i institucioneve.

Sala Shala - Berisha – A do të thotë se është rregulluar kjo problematikë dhe nuk do të përsëritet kjo çështje me ndërprerje drastike të rrymës për qytetarët e Drenasit? A do të thotë se është rregulluar kjo çështje e ndarjes së konsumatorëve të Drenasit nga FERRONIKELI dhe se qytetarët më nuk do të përballen me reduktime të gjata?

Krenar Bujupi – Sa jemi në dijeni, kanë përfunduar punimet për ndarje dhe nuk presim të ketë prapë reduktime për arsye të punimeve.

Rrustem Berisha – Kam disa pyetje. E para, që më intereson, sa është çmimi i importit të energjisë elektrike dhe a keni të dhëna për FERRONIKELIN se sa paguan për importin e rrymës për ndërmarrjen e vet dhe a është çmimi i njëjtë, me çfarë furnizoheni ju dhe me çfarë furnizohet FERRONIKELI? Pyetja e dytë ka të bëjë me Obiliqin. Pse Obiliqi prodhon rrymë për krejt Kosovën dhe vetë Obiliqit i ndalet rryma? Nuk ka rrymë, në fakt ballafaqohet edhe me ndotjen e ambientit dhe me shumë gjëra tjera nga prodhimi i rrymës.

Krenar Bujupi (ZRRE) – Importi i energjisë elektrike, në vitin 2015, ka qenë 51.8 euro, mesatarja, ndërsa eksporti ka qenë prej 29.6 euro mesatarja. Duke kërkuar ndjesë, nuk kisha dashur të hyj në informata se sa FERRONIKELIT i kushton energjia elektrike, sepse është çështje që nuk është e rregulluar nga ZRRE.

Rrustem Berisha – Në Deçan i kemi vizituar, ata e kanë diku 39.5 për megavat orë.

Krenar Bujupi (ZRRE) – Të flas pak për diferencën, pse ata më lirë, kurse ne më shtrenjtë, domethënë mënyra se si kalkullohet çmimi për FERRONIKELIN dhe për nevojat e importit të tij kushton pak më lirë për të gjetur kontraktim ose lloje të energjisë, ndërsa ne, posa e kontraktujmë importin, janë këto çmime që i përmenda, por më duhet të them se që nga viti 2013, e kemi pasur 62 euro, kurse tani e kemi 52 euro, domethënë i kemi 10 euro kursime në çmim të importit.

Kryetari – Do të thotë se kontraktuesi privat po e blen më lirë se sa ai publik, që ka qenë më herët, për ata edhe kemi thënë për t'i privatizuar.

Krenar Bujupi (ZRRE) – Për Obiliqin, mund të themi me siguri të plotë se, si ZRRE, kemi qenë në takime të shpeshta me zyrtarë të Komunës së Obiliqit, zyrtarë të KEDS-it, kemi bërë takime të përbashkëta për të gjitha planet zhvillimore, jemi duke punuar në maksimum që t'i rregullojmë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me planifikimin, mirëmbajtjen, kemi ndihmuar edhe gjatë

takimeve që kanë pasur me KEK-un. Po ashtu, i kemi marrë disa prej kërkesave të Komunës së Obiliqit, por nuk kemi pasur ndonjë kundërshtim. Lidhur me kërkesat, jemi duke punuar në mënyrë të vazhdueshme, që të përmirësojmë sigurinë e furnizimit në të gjithë Kosovën, por në këtë rast, është shumë e vërtetë se edhe ZRRE-ja, edhe qytetarët e kuptojnë që Komuna e Obiliqit është ajo që po e prodhon këtë energji elektrike dhe normalisht nuk është e drejtë që kjo komunë të ketë furnizim jo të mirë me energji elektrike.

Kryetari – Arsyeja pse ju kemi ftuar këtu, është shqetësimi ynë, për arsye të ndërprerjeve të rrymës, më të shprehura në këtë periudhë të vjeshtës dhe dimrit dhe për shkak të ankesave të faturimit. Sigurisht, këto ankesa rreth faturimit do t’i shohim në fund të vitit dhe të shohim bilancin e tërë vitit. Megjithatë, ne jemi 17 vite pas luftës dhe ndërprerjet e tilla të rrymës ishte dashur të jenë të harruara. Nuk mund të pajtohemi dhe të mësohemi që qytetarët e Kosovës mund të mbesin pa drita nga 3-4 orë. Kjo është një çështje jonormale, me të cilën, ne, kurrsesi nuk mund të pajtohemi. Lidhur me tarifën, ka ankesa të mëdha nga bizneset për maksografin, lidhur me prodhimin dhe me këmbimin. Ta keni parasysh se ajo që kërkojmë ne, është furnizimi i rregullt i qytetarëve të Kosovës me rrymë me standardet e duhura. Pra ky është edhe funksioni i Rregullatorit.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- 1. ZRRE-ja, në funksion të mandatit të saj, në pajtim me ligjin, t’u sigurojë furnizim të rregullt qytetarëve të Kosovës me rrymë, me standardet e duhura, si dhe të marrë masat ligjore që të monitorojë ndërmarrjet e energjisë, që të evitohen ndërprerjet e shpeshta të rrymës.*
- 2. ZRRE-ja, të shqyrtojë ankesat e bizneseve për maksografin, lidhur me prodhimin dhe këmbimin.*
- 3. ZRRE-ja, t’i vë në dispozicion Komisionit formulën, me anë të së cilës krijohen tarifën.*

4. Shqyrtimi i nismës legislative: “Plotësimi i Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit”

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, e njoftoi Komisionin se grupi punues i nismës legislative: “Plotësimi i Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit”, ka mbajtur mbledhjen, ku kanë qenë pjesëmarrës edhe përfaqësuesit e AKP-së, për të arsyetuar propozimin për këtë nismë për plotësimin e ligjit në fjalë. Ai tha se gjatë takimit janë dhënë propozimet dhe është hartuar memorandum i shpjegues i projektligjit, ku është paraqitur dhe arsyetuar qëllimi dhe objektivat që rregullohen me këtë projektligj. Pastaj, fjalën ia dha përfaqësuesit të AKP-së, për të arsyetuar propozimin.

Ekrem Hajdari (drejtor në AKP), e arsyetoi propozimin dhe potencoi se sa i përket vlerësimit të ndikimit financiar, në këtë ndryshim, nuk do t’i bëjmë barrë buxhetit, por përkundrazi do të kursehen rreth 300 mijë euro, të cilat janë shpenzuar në përfaqësim për avokat.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet nisma legislative: “Plotësimi i Ligjit nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit.*
- 2. Nisma ligjore t’i procedohet Kryesisë së Kuvendit për mendim në Qeveri, sipas procedurës.*

5. Shqyrtimi i Raportit me rekomandime i Projektligjit nr.05/L-117 për akreditim

Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit, i njoftoi anëtarët e Komisionit, se komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar raportin me amendamentet të Projektligjit për akreditim dhe nuk kanë paraqitur asnjë vërejtje apo sugjerim. Prandaj, si i tillë, sipas procedurës, dërgohet për shqyrtim në seancë plenare për lexim të dytë.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet Raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-117 për akreditim.*
- 2. Raporti me rekomandime t’i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

**6. Të ndryshme
Çështjet vijuese**

Kryetari i ftoi anëtarët e Komisionit, që më datën 21.11.2016, të marrin pjesë në organizimin e punëtorisë me asociacionet e bizneseve, me temën: “Mjedisi biznesor për investime”.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa